

APLIKO
NGA DATA 31 GUSHT
DERI NË 21 TETOR

SHKARKO FORMULARËT E APLIKIMIT NË
www.aida.gov.al

DHE DËRGO NË
ndermarrje@aida.gov.al



PËRFITO DERI NË
2 500 000 lekë



- E-COMMERCE
- WEBSITE
- SISTEME SOFTWERIKE
- MENAXHIM RRJETESH
- APLIKACIONE
- MAKINERI DIGJITALE

**FONDI PËR ZHVILLIMIN
E NDËRMARRJEVE MIKRO,
TË VOGLA DHE TË MESME**

Transformimi digjital luan një rol të rëndësishëm për një të ardhme të qëndrueshme të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). Investimet në teknologji, digjitalizim dhe inovacion, janë bërë të pashmangshme për bizneset që të zhvillohen, të jenë fitimprurëse dhe konkurruese.

AIDA, në mbështetje të NMVM-ve, për vitin 2022, menaxhon grantin e Qeverisë Shqiptare me fokus digjitalizimin e NMVM-ve.

Granti mbështet kompanitë në përmirësimin e proceseve të punës dhe ka për qëllim zhvillimin e biznesit nëpërmjet transformimit digjital.

PËRFITUESIT E FONDIT

Të gjitha ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme që synojnë digjitalizimin në biznesin e tyre, duke përmirësuar kompetencat e punonjësve dhe digjitalizuar proceset strategjike të ndërmarrjes.

FINANCIMI

80% të kostove të miratuara;

Deri në **2,500,000** lekë (dy milionë e pesëqind) lekë për secilën ndërmarrje;

Pagesa e fondit bëhet 50% në fillim të projektit dhe 50% në përfundim të projektit kundrejt dorëzimit të faturave të shpenzimeve, të cilat vërtetojnë shpenzimet e kryera.

* Neni 5 ligji nr. 43/2022

Ndërmarrjet plotësojnë deklaratën e kategorisë si ndërmarrje autonome, ndërmarrje partnere ose ndërmarrje e lidhur, në të cilën përfshihen edhe të dhënat e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji. Mënyra dhe forma e deklarimit të kategorisë së ndërmarrjes gjendet në "Udhëzimin nr.24, mbi deklaratën në përputhje me nenin 5 të ligjit nr. 43".

SI MUND TË PËRDORET GRANTI?

- Për blerjen dhe ndërtimin e pajisjeve ose makinerive të reja digjitale ose teknologjike.
- Për blerjen dhe ndërtimin e aplikacioneve për shërbim klienti apo menaxhim të dhënash.
- Për ndërtimin e një faqeje web-i ose platforme online për marketingun e kompanisë, promovimin dhe ndërlidhjen me klientët.
- Për blerjen dhe ndërtimin e aplikacioneve ose programeve apo paketave të ndryshme të programeve kompjuterike.

KRITERET E APLIKIMIT

- Të jeni persona fizikë apo juridikë, të regjistruar në regjistrin tregtar, për jo më pak se 12 muaj.
- Të mos jeni në proces falimentimi.
- Të keni paguar rregullisht sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore.
- Të mos keni detyrime ndaj organeve doganore dhe tatimore në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi.
- Të keni dorëzuar deklaratën në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 5 të ligjit nr. 43/2022*.



DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Formulari i buxhetit;
- Deklarata në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 5 të ligjit nr. 43/2022;
- Ekstrakti i QKB-së;
- Certifikata e regjistrimit në regjistrin tregtar;
- Akt themelimi dhe statuti;
- Vërtetim nga Drejtoria e Tatim-Taksave që aplikuesi, nuk ka detyrime të pashlyera për sa u përket kontributeve për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatim-taksat;
- Kopje të ID-së të aplikuesit;
- Dëshmi penaliteti e drejtuesit ekzekutiv ose e administratorit;
- Çdo dokument tjetër shoqëruar që në vlerësimin e aplikuesit mbështet aplikimin e tij/saj.

SI APLIKOHET?

- Dorëzimi i kërkesave nga aplikantët do të bëhet vetëm nëpërmjet adresës elektronike të AIDA-s ndermarrje@aida.gov.al.
- Formatet e formularit të aplikimit, të buxhetit dhe deklarata në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 5 të ligjit nr. 43/2022 do të shkarkohen në linkun: <https://aida.gov.al/sq/-dokumentet-e-aplikimit>.
- Formatet do të plotësohen nga aplikuesi dhe së bashku me dokumentacionin e kërkuar do të dërgohen me e-mail.

- Formatet e aplikimit dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të jenë në formatin pdf.
- Dokumentacioni i kërkuar duhet të jetë kopje e skanuar nga origjinali.
- Subjekti i e-mailit të aplikimit: < Aplikim ndermarrje >.
- Aplikuesi do të marrë përgjigje nëpërmjet një e-maili automatik, i cili do të konfirmojë marrjen e aplikimit.

ANGAZHIMI I PËRFITUESVE

Respektimi në mënyrë rigorozë dhe integrale i të gjithë deklaratave dhe angazhimeve të përfshira në formularin e aplikimit.

Vënia në dispozicion e çdo informacioni që lidhet me zbatimin e projektit;

Paraqitja pranë AIDA-s e raportit në lidhje me përfundimin e projektit, faturat origjinale për shpenzimet, si dhe çdo dokument të nevojshëm për të bërë të mundur kryerjen e pagesës;

Pranimi i çdo lloj monitorimi, vlerësimi dhe/apo auditimi për të cilat projekti i aprovuar mund të bëhet objekt, duke siguruar të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, me një njoftim paraprak prej 48 orësh.

Përfundimi i projektit brenda kohës së parashikuar në marrëveshje.

Dhënia e informacionit në lidhje me zbatimin e grantit dhe rezultatet e arritura me qëllim publikimin, shpërndarjen dhe promovimin e tyre nga AIDA, pa ndonjë kufizim.



FONDI PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME

AIDA KONTAKT:

✉ info@aida.gov.al

🌐 aida.gov.al

☎ +355 (0)42 251 001

🐦 [@investinalbania](https://twitter.com/investinalbania)

📷 [@aida__albania](https://www.instagram.com/aida__albania)

📘 AIDA - Albanian Investment Development Agency